

KOSOVO



KOMITETI OLIMPIK I KOSOVËS
KOSOVA OLYMPIC COMMITTEE

RREGULLORE
PËR PROCEDURAT E ZGJIDHJES SË KONFLIKTEVE PËRMES
KOMISIONIT TË ARBITRAZHIT SPORTIV "KAS"
TË KOK

Prishtinë, 26.12.2020

Sipas autoritetit të dhënë në bazë të Statutit të Komitetit Olimpik të Kosovës - KOK, Bordi Ekzekutiv i KOK, në mbledhjen e tij të 54-të, të datës 07.12.2020 i propozoi për miratim Asamblesë së KOK:

Rregulloren e Komisionit të Arbitrazhit Sportiv

KAPITULLI I – TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Dispozita të Përgjithshme

- 1.1.** Kjo Rregullore përcakton procedurat e punës si dhe organizimin e Këshillit të Arbitrazhës Sportive të Komitetit Olimpik të Kosovës (në tekstin e mëtejme "KAS"), juridiksionin dhe përbërjen e Gjykatës së Arbitrazhit Sportiv, rregullat e arbitrazhit, procedurën si dhe shpenzimet paraprake për hapjen e procedurave apo konflikteve në "KAS".

Neni 2

Baza Ligjore

- 2.1.** "KAS" është krijuar dhe funksionon në bazë të:
a) Kartës Olimpike neni 74, Kreu V;

B.H

- b) Statutit të KOK;
- c) Ligji Nr. 04/L-075 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 2003.24 për Sport;
- d) Statuteve dhe rregulloreve të anëtarëve të KOK;

Neni 3 Misioni dhe Parimet e “KAS”

- 3.1. Misioni i “KAS” është zgjidhja e mosmarrëveshjeve/konflikteve në fushën e sportit nëpërmjet arbitrazhit. “KAS” e ushtron këtë funksion me anën e dhënies së Vendimeve të Arbitrazhit, të cilat janë të njohura nga legjislacioni në fuqi i Republikës së Kosovës, dhe kanë të njëjten forcë ligjore dhe zbatueshmëri, sikur të ishte një gjykatë shtetërore.
- 3.2. “KAS” ka funksion të ndihmojë palët në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të tyre në mënyrë miqësore, nëpërmjet “ndërmjetësimit”, si dhe dhënies së “opinioneve” dhe “këshillave” për këtë qëllim, mbi çdo çështje të së drejtës që rregullon sportin apo zhvillimin e sportit.
- 3.3. “KAS” i ushtron funksionet e tij të lartpërmendura, duke respektuar parimet e pavarësisë, konfidencialitetit dhe paanshmërisë.

Neni 4 Zbatimi i Dispozitave të Rregullores

- 4.1. Kompetenca si dhe procedurat e “KAS”-it aplikohen për zgjidhjen e konflikteve ndërmjet sportistëve, personave juridike si dhe fizikë të cilët kryejnë aktivitete sportive, federatave, klubeve sportive, shoqatave sportive si dhe organizatave të tjera në fushën e sportit, për të drejtat me të cilat palët disponojnë, dhe në rast se ndonjë Ligj tjetër nuk është paraparë për zgjidhjen e këtyre konflikteve si dhe juridiksioni ekskluziv nuk i takon ndonjë Gjykatë të Republikës së Kosovës.
- 4.2. “KAS” bën shqyrtimin e mosmarrëveshjeve në dy shkallë.
- 4.3. Në shkallë të parë “KAS” bën shqyrtimin e mosmarrëveshjeve me:
 - a) Karakter tregtar (ekzekutimin e kontratave, sponsorizimi i aktiviteteve, shitja e të drejtave televizive etj), dhe
 - b) Të lidhura me përgjegjësitë civile (aksidentimin e një sportisti, dëmtimin e pronës së klubeve sportive, dëmtimin e imazheve të klubeve sportive apo federatave etj).
- 4.4. Në shkallë të dytë “KAS” bën shqyrtimin e mosmarrëveshjeve:
 - a) Mosmarrëveshje midis Federatave, klubeve, shoqatave, organeve drejtuese të tyre, si dhe organizmave të tjerë sportive;
 - b) Mosmarrëveshjeve të lindura mbi masat disiplinore (përdorimi i dopingut apo substancave të tjera të ndaluara, shkeljet disiplinore përgjatë aktiviteteve sportive etj).
- 4.5. Çdo person fizik apo juridik, i cili ka zotësinë juridike për të vepruar mund t’i drejtohet Komisionit të Arbitrazhit Sportiv, nga fusha e sportit si sportistët, klubet, federatat sportive, organizuesit e aktiviteteve sportive, sponsorizuesit, kompanitë televizive etj.
- 4.6. Dispozitat e kësaj Rregullore aplikohen për të gjitha konfliktet dhe mosmarrëveshjet që hyjnë në kompetencë të “KAS”-it.

Neni 5 Përkufizimet

- 5.1. Në këtë Rregullore:
 - a) Këshilli i Arbitrazhës Sportive “KAS” do të thotë trupa e pavarur për zgjedhjen e konflikteve në sport, e që vepron në kuadër të Komitetit Olimpik të Kosovës;

- b) Gjykata e Arbitrazhit Sportiv "GJAS" do të thotë një (1) arbitër ose një trup arbitrazhit të cilët veprojnë si dhe vendosin për një konflikt specifik;
- c) Paditësi tregon palën që fillon procedurën e arbitrazhit, përfshirë një ose më shumë paditësa nëse ka të tillë;
- d) I pandehuri nënkupton palën ndaj së cilës janë nisur procedurat e arbitrazhit si dhe mund të përfshijë një ose më shumë të pandehur, nëse ka të tillë;
- e) Një palë ose palët do të thotë paditësi/ja dhe i pandehuri/të;
- f) Padi përbën një parashtresë me shkrim nga paditësi/ja, dhe me të cilën fillon procedura e arbitrazhit pranë "KAS"-it;
- g) Vendim nënkupton çdo lloj vendimi të marrë nga tribunali i arbitrazhit.

Neni 6

Komisioni i Arbitrazhit Sportiv

- 6.1. Brenda Komitetit Olimpik të Kosovës operon "KAS";
- 6.2. "KAS" është një organ i përhershëm dhe i pavarur;
- 6.3. "KAS" e ka selinë në Prishtinë.
- 6.4. "KAS" e ka vulën e vet me mbishkrim "Komitetit Olimpik i Kosovës – Komisioni i Arbitrazhit Sportiv".

Neni 7

Komiteti Olimpik i Kosovës

- 7.1. Komiteti Olimpik i Kosovës (në tekstin e mëtejme "KOK") siguron kushtet hapësinore dhe administrative-teknike për kryerjen e veprimtarisë së "KAS".

KAPITULLI II

ORGANIZIMI I KOMISIONIT TË ARBITRAZHIT SPORTIV

Neni 8

Funksionet në "KAS"

- 8.1. "KAS" është një organ i pavarur i Komitetit Olimpik të Kosovës, dhe ka për funksion zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe konfliktëve rreth të drejtave që palët kanë në dispozicion, përveç nëse ekziston një kompetencë ekskluzive për një lloj të tillë mosmarrëveshesh në ndonjë Gjykatë të Republikës së Kosovës.

Neni 9

Kush mund të zgjidhet dhe si zgjidhen anëtarët e KAS të KOK

- 9.1 Anëtar i KAS mund të zgjidhet personi i cili është i jurist i diplomuar dhe që ka përvojë punë së paku 3 vite në profesion;
- 9.2 Personi që ka përvojë dhe njohje të funksionimit të sportit kosovar;
- 9.3 Ai duhet të jetë shtetas i Kosovës;
- 9.4 Ai duhet të jetë i dëshmuar për etikën profesionale, drejtësinë, paanshmërinë, përgjegjshmërinë etj;
- 9.5 Propozimet për tu zgjedhë anëtar i KAS mund ti bëjnë federatat sportive në Asamblenë e Përgjithshme të KOK, kur KOK i shpallë zgjedhjet për KAS;

b.H

- 9.6 Secila federatë sportive anëtare e KOK mund të propozoj një kandidat për anëtar të KAS nëse i plotëson kriteret e theksuara më lartë në këtë nen;
- 9.7 Asambleja e Përgjithshme do të zgjedhë 9 anëtar të KAS nga lista e propozimeve të ardhura nga federatat sportive;

Neni 10 **Organet e "KAS"**

Organet e KAS janë:

- a) Kryetari, Nëkryetari dhe Sekretari i Përgjithshëm i "KAS";
- b) Arbitërit;
- c) Gjykata e Arbitrazhës Sportive që merret me zgjidhjen e konflikteve në "KAS";
- d) Sekretaria e "KAS";

Neni 11 **Kryetari i "KAS"**

- 11.1 Puna e "KAS" menaxhohet nga Kryetar i "KAS";
- 11.2 Kryetar i "KAS" mund të emërohet një personi i diplomuar - Jurist (i cili ka kryer studime juridike katërvjeçare ose studime juridike sipas programit të studimit sipas ECTS me 300 kredi) me të paktën 3 vite përvojë pune në profesion, si dhe të ketë përvojë pune në menaxhimin e organizatave sportive;
- 11.3 Kryetari i "KAS" emërohet nëpërmjet votimit të hapur nga anëtarët e tij me shumicë votash për një periudhë 4 (katër) vjeçare me të drejtë rizgjedhjeje.

Neni 12 **Kompetencat e Kryetarit të "KAS"**

- 12.1 Kryetari i "KAS" kryen këto aktivitete:
- a) Të emërojë arbitrin, ose kryetarin e Gjykatës së arbitrazhës sportive në rastet e parashikuara në këtë Rregullore;
 - b) Propozon përjashtimin dhe zëvendësimin e arbitrit në raste të arsyeshme;
 - c) Dorëzonë një program vjetor të "KAS" në Asamblenë Vjetore dhe BE të KOK;
 - d) Dorëzonë një raport vjetor mbi pasqyrat financiare në Asamblenë Vjetore dhe BE të KOK;
 - e) Kryenë aktivitete të tjera, të përcaktuara me dispozitat e "KAS" dhe kësaj rregulloreje.

Neni 13 **Nënkryetari i KAS**

- 13.1 Nënkryetari i "KAS" do të zëvendësojë kryetarin e "KAS" kur ai nuk mund të kryej detyrat e tij, si dhe në rastet kur Kryetari i "KAS" do të transferojë kompetencat e tij te Nënkryetari i "KAS";
- 13.2 Nënkryetar mund të emërohet personi i diplomuar - Jurist (i cili ka kryer studime juridike katërvjeçare ose studime juridike sipas programit të studimit sipas ECTS me 300 kredi) me të paktën 3 vite përvojë pune në profesion, si dhe të ketë përvojë pune në menaxhimin e organizatave sportive;
- 13.3 Nënkryetari i "KAS" emërohet nëpërmjet votimit të hapur nga anëtarët e tij me shumicë votash për një periudhë 4 (katër) vjeçare me të drejtë rizgjedhjeje.

b.H

Neni 14
Sekretari i Përgjithshëm i "KAS"

- 14.1. "KAS" ka një Sekretar të Përgjithshëm;
- 14.2. Sekretari i Përgjithshëm i KAS duhet të jetë jurist i diplomuar dhe të ketë përvojë minimum 3 vjeçare në profesion, si dhe të ketë njohje të Lëvizjes Olimpike;
- 14.3. Sekretari i Përgjithshëm zgjedhet njëri nga anëtarët e KAS;
- 14.4. Sekretari i Përgjithshëm zgjedhet me vota të hapura nga shumica e anëtarëve të KAS, për një mandat 4 vjeçar, me mundësi rizgjedhjeje.

Neni 15
Kompetencat e Sekretarit të Përgjithshëm të KAS

- 15.1. Sekretari i Përgjithshëm i "KAS":
 - a) Kryen punë administrative dhe teknike për "KAS";
 - b) Merr përsipër veprimet administrative për themelimin e Gjykatës së Arbitrazhit Sportiv dhe përgatit materiale për zgjidhjen e një mosmarrëveshje në një rast të veçantë;
 - c) Kujdeset për ekzekutimin e duhur të konkluzioneve dhe vendimeve të tjera të Gjykatës së Arbitrazhit Sportiv;
 - d) Përgatit raportin vjetor të punës, pasqyrat financiare vjetore, harton planin e punës dhe atë financiar të cilat i'a dorëzon Kryetarit të "KAS";
 - e) Kryenë aktivitete të tjera, të përcaktuara me aktet e "KAS", si dhe detyra tjera që i ngarkon "KAS";
- 15.2. Në rast të pezullimit të përkohshëm të Sekretarit të Përgjithshëm të "KAS", Kryetari i "KAS" do të emërojë një person për të zëvendësuar Sekretarin e Përgjithshëm të "KAS" dhe si rregull nga punonjësit e KOK apo të BE të KOK.

Neni 16
16. Gjykata e Arbitrazhës Sportive (GJAS)

- 16.1. Gjykata e Arbitrazhës Sportive përbëhet nga një ose tre arbitra të emëruar nga radhët e anëtarëve të KAS;
- 16.2. Në rastet kur KAS vendosë që një rast të gjykohet nga një Arbitër, ai emrohet nga Kryetari i KAS;
- 16.3. Kur KAS vendosë që GJAS të ketë tre arbitra për rastin, dy arbitra do të propozohen nga palët në konflikt, ndërsa kryetarin e GJAS e propozon Kryetari i KAS;
- 16.4. Arbitrat e GJAS nuk duhet të kenë konflikt interesi me ndonjërin nga palët në konflikt;

Neni 17
Përgjegjësi të tjera të Organeve të KAS

- 17.1. Kryetari, Nënkyetari dhe Sekretari i Përgjithshëm i "KAS" ndërmarrin aktivitete të nevojshme për zhvillimin dhe promovimin e "KAS" në Republikën e Kosovës;
- 17.2. Kryetari, Nënkyetari dhe Sekretari i Përgjithshëm i "KAS" do të respektojnë edhe legjislacionin e Republikës së Kosovës që i referohet sportit dhe arbitrazhit, duke mbikëqyrë zbatimin e këtyre akteve në "KAS", si dhe propozojnë amendamentet dhe plotësime të kësaj Rregullore si dhe Rregulloreve të tjera në Bordin Ekzekutiv të KOK-ut dhe Asamble të KOK;
- 17.3. Kryetari, Nënkyetari dhe Sekretari i Përgjithshëm i "KAS" organizojnë dhe zhvillojnë seminare, këshilla, trajnime, biseda profesionale dhe ngjarje të tjera në mënyrë që të

familjarizojnë publikun e gjerë dhe komunitetin sportiv, për punën e “KAS”, pastaj të marrin pjesë në takimet shkencore dhe profesionale në vend dhe jashtë vendit, të përgatisin dhe të publikojnë dokumente profesionale dhe shkencore lidhur me mënyrën e zgjidhjes së konflikteve të sportit përmes Këshillit të Arbitrazhit Sportiv;

17.4. Kryetari, Nënkyetari dhe Sekretari i Përgjithshëm i “KAS” do të mbajnë kontakte të rregullta me Gjykatën e Arbitrazhit të Sportit (CAS) në Lausanne, Zvicër;

17.5. Me kërkesë të KOK, MKRS dhe federatave sportive jep këshilla juridike rreth harminizimit të statuteve të tyre me statutin e KOK dhe Ligjin për Sport, statutet e federatave ndërkombëtare dhe kodet e mirësjelljes;

Neni 18

Lista e arbitrave

17.1. “KAS” ka një listë prej 9 arbitrave të zgjedhur në Asamblenë Zgjedhore të KOK;

17.2. Sekretaria e KAS mbanë listën e përditësuar të arbitrave të zgjedhur dhe emruar në GJAS për të gjitha rastet .

KAPITULLI III – RREGULLAT E ARBITRAZHIT

Neni 19

Kompetenca dhe përbërja e Këshillit të Arbitrazhës Sportive

19.1. Aktivizimi i punës së Këshillit të Arbitrazhit Sportiv lindë nga një konflikt në mes të dy apo më shumë palëve.

19.2. Konflikti do të konsiderohet se ekziston atëherë kur:

a) Ekziston mosmarrëveshje/konflikt midis palëve;

b) Prishet një marrëveshje arbitrazhi me të cilën është menduar se është zgjidhë mosmarrëveshja pranë “KAS”.

c) Pranohet një padi apo shkresë tjetër pasi që janë shterur të gjitha burimet e tjera, dhe në të cilën paditësi pohon ekzistencën e konfliktit, si dhe ekziston një i pandehur.

19.3. Gjatë procedurave që lindin si pasojë e konflikteve midis dy apo më shumë palëve, GJASi do të bëjë përpjekje të zgjidh konfliktin në mënyrë paqësore.

Neni 20

Kundërshtimi ndaj paaftësisë/juridiksioni

19.1. Çdo kundërshtim për ekzistencën dhe vlefshmërinë e padisë apo konfliktit ose mos-juridiksioni i GJAS duhet të dorëzohet jo më vonë se dita e dëgjimit të parë, dhe nëse procedura kryhet pa mbajtjen e seancës dëgjimore, jo më vonë se kur përgjigja ndaj padisë do t'i dorëzohet paditësit. Kundërshtimi duhet të dorëzohen me shkrim në “KAS”.

19.2. Vetëm Këshilli i Arbitrazhës Sportive “KAS” mund të vendosë për kundërshtimin e jokompetencës së GJAS.

19.3. Nëse pala paraqet një ankesë para vendosjes së arbitrazhit do të miratohet vendimi mbi kundërshtimin për/kundër mos-juridiksionit nga “KAS”.

Neni 21

Përbërja e Gjykatës së Arbitrazhit Sportiv “GJAS”

21.1. Gjykata e Arbitrazhit Sportiv “GJAS” përbëhet nga 1 ose 3 arbitra;

B.H

- 21.2. Arbitrat zgjidhen dhe emrohen nga lista e arbitrave të KAS;
- 21.3. Pala që ankohet për zgjedh një anëtar nga anëtarët e KAS si arbitër (nga 8 te mundshëm, pa kryetarin e KAS). Përgjigjia nga pala ankuese se cilin anëtarë të KAS e për zgjedh për arbitër duhet të jipet brenda 24 orëve nga momenti i marrjes së njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm i KAS;
- 21.4. Pala që mbrohet për zgjedh njërin nga anëtarët e KAS për arbitër (nga 7 te mundshëm, pa kryetarin e KAS dhe pa anëtarin e zgjedhur nga pala që ankohet) brenda 24 orëve;
- 21.5. Nëse palët në kontest kanë përcaktuar nga një arbitër sipas procedurave në fuqi, Kryetari i Gjykatës së Abitrazhit Sportiv propozohet dhe emrohet nga Kryetari i KAS për rastin konkret (Kryetari ka të drejtë ta propozoj dhe emëroj edhe veten);
- 21.6. Nga ky rregull bëhet përjashtim në rast të konfliktit të interesit. Atëherë kur pala ankuese ose pala për të cilën është bërë ankesa ose edhe Kryetari i KAS, nuk mundën me e për zgjedhë ose me e emëruar anëtarin e KAS në rastin konkret si anëtar të GJAS, në rast se KAS konstaton se anëtari i për zgjedhur ose i emëruar, ka konflikt interesi në lëndën në fjalë, atëherë duhet emëruar anëtari tjetër për arbitër në procedurën e njëjt;
- 21.7. Në rast se asnjëra nga palët, ose njëra palë nuk ka për zgjedhur arbitrin nga lista e KAS, propozimin dhe emërimin për arbitrin e bënë KAS;
- 21.8. Çdo person që do të zgjidhet në listë ose që do të emërohet arbitër do të veprojë në përputhje me këtë Rregullore;

Neni 22

Caktimi i një arbitri-individi

- 22.1 Një arbitër individual mund të veprojë pas emrimit të KAS dhe vetëm nëse palët janë pajtuar;
- 22.2 Në rastet nga paragrafi 1 i këtij neni, palët janë të detyruara të paraqesin tek Sekretari i Përgjithshëm emrin e një arbitri-individi jo më vonë se 5 ditë nga data e dërgimit të kërkesës e nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm, me të cilën palët njoftohen së procedura e konfliktit të pretenduar ka filluar nga KAS;
- 22.3 Nëse palët nuk e paraqesin emrin e arbitrit në afatin e caktuar të përcaktuara në paragrafin 22.2 të këtij neni, në atë rast Sekretari i Përgjithshëm i "KAS" do t'i paraqesë palëve listën e arbitrave me një thirrje brenda 24 orëve që secila nga palët duhet ta zgjedh një arbitër. Nëse zgjedhin të dyja palët të njëjtin person për arbitër, ai person do të emërohet si arbitër i vetëm;
- 22.4 Nëse palët nuk zgjedhin të njëjtin person si një arbitër nga lista e propozuar në pajtim me paragrafin (22.3) të këtij neni, atëher arbitrat e GJAS do të emrohen sipas nenit 21 të kësaj rregulloreje;

Neni 23

Emërimi i arbitrave në rastin e bashkë-paditësve

- 23.1. Nëse disa paditës paraqiten në një mosmarrëveshje, apo konflikt të pretenduar, në të njëjtin rol ose të të pandehurit, ata janë të detyruar të arrijnë një marrëveshje për caktimi i një arbitri të përbashkët.
- 23.2. Nëse palët nga paragrafi 23.1 i këtij neni nuk caktojnë një arbitër të përbashkët sipas procedurës së përcaktuar në nenin 21 i kësaj rregulloreje. Nëse një person zgjidhet nga të gjitha palët, ai person do të jetë i emëruar për arbitërin e përbashkët të bashkë-mbrojtësve apo të bashkë-paditësve;
- 23.3. Nëse arbitri i përbashkët nuk mund të emërohet në përputhje me paragrafët 23.1 dhe 23.2 të këtij neni, arbitri emërohet nga Kryetari i "KAS".

B.H

Neni 24

Njoftimi për emërimin dhe pranimin e emërimit

- 24.1. Sekretari i Përgjithshëm i "KAS" njofton personat e caktuar për arbitrat e zgjedhur nga palët brenda 3 ditëve nga dita kur emri i tyre i dorëzohet Sekretarit të Përgjithshëm;
- 24.2. Nëse, brenda 5 ditëve nga dita e pranimin të njoftimit, arbitri i emëruar nuk ka paraqitur një deklaratë që pranon emërimin dhe një deklaratë të paanshmërisë dhe pavarësisë, konsiderohet se ka hedhur poshtë emërimin;
- 24.3. Nëse arbitri refuzon emërimin e palëve, Sekretari i Përgjithshëm i "KAS" do të thërrasë palën që ka emëruar arbitrin, brenda 3 ditëve për të emëruar një person tjetër si një arbitër.
- 24.4. Sekretari i Përgjithshëm njofton palët për pranimin e emërimit të arbitrit tjetër brenda 3 ditëve nga data e marrjes së njoftimit.

Neni 25

Paanshmëria dhe pavarësia e arbitrave

- 25.1. Çdo person që mund të bëhet arbitër duhet të jetë i paanshmëm dhe i pavarur. Çdo individ që është pjesë e një mosmarrëveshje të tillë, në rast se vërejnë një dukuri që mund të çojë në një dyshim të justifikuar të paanshmërisë dhe pavarësisë së palëve apo të arbitërave, do të njoftojnë udhëheqësit e "KAS".
- 25.2. Me dorëzimin e deklaratës së pranimin të emërimit, arbitri duhet të paraqesë një deklaratë të paanshmërisë dhe pavarësisë. Në deklaratë arbitri duhet patjetër t'i zbulojë palëve ato rrethana që një palë e tretë e arsyeshme do t'i konsideronte si rrethana që prekin paanshmërinë dhe / ose pavarësinë e arbitrit dhe konfliktin e interesit, e në veçanti:
 - a) çdo marrëdhënie me palët, ose çdo person tjetër që merr pjesë në procedurën e arbitrazhit;
 - b) nëse ekziston një interes financiar i menjëhershëm ose i tërthortë në lidhje me zgjidhjen e çështjes;
 - c) nëse ka informata konfidenciale lidhur me çështjen e mosmarrëveshjes, të cilën e mësoi nga burime jashtë procedurës së arbitrazhit etj;
- 25.3. Sekretari i Përgjithshëm i "KAS" deklaratën për paanshmëri dhe pavarësi të arbitrave së bashku me deklaratën e pranimin të emërimit të tyre, do t'i dërgojë tek palët brenda 5 ditëve nga dita e dorëzimit të deklaratës.

Neni 26

Përfundimi i mandatit të një arbitri

- 26.1. Mandati i arbitrit pushon:
 - a) me nënshkrimin e vendimit të arbitrazhit, një aktgjykim tjetër, dhe duke nënshkruar interpretimin dhe korigjimin e dhënies së arbitrazhit, në rast të gjykimit të pjesshëm apo gjykimit shtesë;
 - b) me përjashtim;
 - c) duke nxjerrë një vendim mbi ndërprerjen e mandatit të arbitrit për shkak të dështimit ose moszbatimit të detyrës së një arbitri;
 - d) përshkak të pamundësisë ose paafësisë për të kryer detyrën për arsye e rrethana të ndryshme;

B.H

Neni 27
Përfashtimi i Arbitrit

- 27.1. Përfashtimi i arbitrit mund të kërkohet nëse ekzistojnë rrethana të dyshimta në lidhje me paanësinë dhe / ose pavarësinë, ose nëse vërtetohet konflikti i interesit e arbitri nuk e ka deklaruar në deklaratën e tij;

Neni 28
Përfashtimi i detyrueshëm i një arbitri

- 28.1. Arbitri është përfashtuar detyrueshëm nëse:
- a) ai është pjesë e strukturave drejtuese të një partie politike, nëse me të pala është në lidhje si bashkëpronar të ndonjë biznesi, kanë një debitor të përbashkët ose nëse dëgjohet si dëshmitar ose ekspert në të njëjtin rast;
 - b) nëse është përfaqësues ligjor ose prokuror i ndonjë të afërmi të gjakut në vijë të drejtë në çdo shkallë, dhe në një vijë anësore në një shkallë të katërt, ose është një bashkëshort, një partner jashtëmartesor ose një i afërm deri në shkallën e dytë, pavarësisht nëse martesa ka pushuar ose jo;
 - c) nëse është kujdestar, prind adoptues, kujdestar ose kujdestar i palës, përfaqësuesit ose avokat i saj ligjor i palës;

Neni 29
Procedura e përfashtimit të arbitrit

- 29.1. Një palë që synon të kërkojë refuzimin e një arbitri është i detyruar të paraqesë një kërkesë me shkrim për një përfashtim tek Sekretari i Përgjithshëm i "KAS" brenda 5 ditëve nga data e gjetjes së arsyes së përfashtimit për një Arbitër.
- 29.2. Sekretari i Përgjithshëm i "KAS"- e paraqet kërkesën tek arbitri i të cilit kërkohet përfashtimi, si dhe tek Presidenti i KAS.
- 29.3. Nëse arbitri, përfashtimi i të cilit kërkohet, nuk tërhiqet, pra pala që emëroi arbitrin nuk pajtohet me përfashtimin, vendimin për përfashtim do të miratohet nga KAS.

Neni 30
Dështimi ose moszbatimi i detyrës së një arbitri

- 30.1. Nëse arbitri, për arsye ligjore ose faktike, nuk është në gjendje të kryejë detyrën e tij, ose për arsye të tjera që ndërlidhen me shkëljen reputacionit të palëve dhe sportit në Republikën e Kosovës, mandati i tij pushon nëse ai vetë tërhiqet nga ajo pozitë ose nëse palët bien dakord për përfundimin e saj.
- 30.2. Nëse palët nuk bien dakord për ndërprerjen e detyrës së arbitrit, sipas pikës 1 të këtij neni, secila palë mund të kërkojë nga Kryetari i "KAS" të marrë një vendim për ndërprerjen e mandatit të arbitrit.

Neni 31
Emërimi i arbitrit të GJAS

- 31.1. Në rastet kur arbitri përfundon mandatin e tij në bazë nenit 29 dhe 30, kur vetë arbitri tërhiqet nga detyra e arbitrit, kur vetë palët do të vendosin të përfundojnë mandatin e arbitrit si dhe në raste të tjera të ndërprerjes së mandatit të arbitrit, do të emërohet arbitri

tjetër në pajtim me rregullat dhe procedurën e emërimit që ishin aplikuar kur emërohet një arbitër që do të zëvendësohet.

Neni 32

Përsëritja e seancës përpara tribunalit të ndryshuar të arbitrazhit

- 32.1. Nëse gjatë procedurës ndryshohet përbërja e arbitrazhit në fazën e këshillave apo dëgjimit, seanca përsëritet, përveç nëse palët bien dakord ndryshe.
- 32.2. Nëse një arbitër zëvendësohet dhe nëse ai zëvendësohet nga Kryetari i KAS, procedura përsëritet në mënyrë të njëjtë.

Neni 33

Rregullat e Arbitrazhit

- 33.1. Përveç nëse përcaktohet ndryshe me këtë Rregullore, Gjykata e Arbitrazhit Sportiv mund të kryejë një procedurë arbitrazhi në mënyrën që e konsideron të jetë më e përshtatshme, duke marrë parasysh rrethanat dhe interesat e palëve, duke marrë parasysh secilën palë në secilën fazë të procedurës dhe duke i dhënë një mundësi të caktuar për të paraqitur faktet, pretendimet ligjore dhe kërkesat.
- 33.2. Të gjitha parashtresat, dokumentet dhe informacione të tjera që një palë duhet t'i dorëzojë në Gjykata e Arbitrazhit Sportiv, do të dorëzohen edhe në palën e kundërt. Çdo raport i ekspertëve do t'u dorëzohet palëve, si dëshmi e një dokumenti në bazë të të cilit Gjykata e Arbitrazhit Sportiv mund ta bazojë vendimin e saj.

Neni 34

Vendi i arbitrazhit

- 34.1. Gjykata e Arbitrazhit Sportiv mund të vendosë të mbajë seanca dëgjimore ku i fton dy palët në ambient të përshtatshëm në hapsirat e KOK në Prishtinë. Nëse nuk është e mundur që seancat të mbahet në hapësirat e KOK për ndonjë arsye, atëherë seanca mund të mbahet në ambiente tjera të përshtatshme për mbajtjen e një seancë gjyqësore;

Neni 35

Gjuha e procedurës

- 35.1. Procedura do të kryhet në gjuhën shqipe dhe alfabetin e saj;
- 35.2. Gjykata e Arbitrazhit Sportiv mund t'i urdhërojë palët në secilin vendim verbal për ndonjë deklaratë që duhet të mbyllet si dhe të përkthehet në gjuhën shqipe;
- 35.3. Të gjitha provat që nuk janë në gjuhën në të cilën zhvillohet procedura duhet të jenë paraqitur në origjinal dhe me një përkthim zyrtar në gjuhën në të cilën është duke u kryer procedura;

Neni 36

Dorëzimi i komunikimeve me shkrim

- 36.1. Nëse palët nuk kanë rënë dakord ndryshe:
 - a) Komunikimi me shkrim do të konsiderohet se është pranuar në ditën kur do t'i dorëzohet personit të cilit i është adresuar, kur do t'i dorëzohet në selinë e tij, vendbanimin e përhershëm apo me adresë postare. Nëse asnjë nga këto vendet nuk mund të përcaktohen pasi të jetë bërë një hetim i arsyeshëm, komunikimi me shkrim do të konsiderohet se është marrë duke e dorëzuar atë tek adresa e fundit e njohur e të

- adresuarit, me një letër të rekomanduar, përmes e-mailit, telegramit, ose telefon, në qoftë se data kur duhet të jepet deklarata me shkrim se është pranuar ose ndryshe me anë të së cilës mund të përcaktohet se është bërë përpjekje për shpërndarjen;
- 36.2. Të gjitha komunikimet me shkrim duhet të dorëzohen tek Sekretari i Përgjithshëm i “KAS” i cili pastaj i paraqet të gjitha tek palët dhe Gjykata e Arbitrazhit Sportiv;
- 36.3. Dorëzimi i komunikimit me shkrim do të konsiderohet se ekzekutohet edhe atëherë kur pala ose përfaqësuesi i saj refuzon ta pranojë atë shkresë që është e adresuar për të;

Neni 37

Fillimi i procedurave të arbitrazhit

- 37.1. Procedura e arbitrazhit fillon me padi, e cila dorëzohet drejtpërdrejt në KAS.
- 37.2. Padia duhet të përfshijë elementet e mëposhtme:
- a) emri i plotë dhe të dhënat e palëve (adresat e palëve, telefonat, faks, adresë e-mail)
 - b) kërkesa për shqyrtimin e rastit;
 - c) faktet mbi bazën e të cilave bazohet kërkesa;
 - d) dëshmi;
 - e) emri i arbitrit të propozuar si përfaqësues i palës;
 - f) treguesin e vlerës së mosmarrëveshjes, nëse ka të tillë;
 - g) Nënshkrimi i aplikuesit, ose nënshkrimi elektronik.
- 37.3. Padia, përgjigja në padi, shtojcat e padisë si dhe përgjigja e padisë në ankesën së bashku me dokumentet e tjera plotësuese do të dorëzohen në numër të mjaftueshëm kopjesh për të gjitha palët kundërshtare, arbitrat dhe KAS.

Neni 38

Afati për përgjigje në padi

- 38.1. Sekretari i Përgjithshëm i “KAS”, pas shqyrtimit të padisë në “KAS”, i’a dorëzon të pandehurit përgjigjen dhe përcakton afatin për përgjigje ndaj një padie që nuk mund të jetë më e shkurtër se 15 ditë.
- 38.2. Nëse ankesa nuk është e plotë dhe nuk i përmbanë të gjitha elementet, Sekretari i Përgjithshëm i “KAS” do t’ia kthejë padinë paditësit dhe do të përcaktojë një afat shtesë për korrigjimin e mangësive. Nëse paditësi nuk vepron sipas udhëzimeve, ankesa do t’i dorëzohet Kryetarit të “KAS” në mënyrë që ai të vendosë.

Neni 39

Përgjigja në një padi

- 39.1. Dispozitat e nenit 37 gjithashtu zbatohen për përgjigjen ndaj padisë/ankesës.
- 39.2. Përgjigja në padi duhet t’i dorëzohet “KAS” dhe Sekretarit të Përgjithshëm në “KAS” brenda tri ditësh, duke dhënë përgjigjen së bashku me bashkëngjitjet e paditësit.

Neni 40

Modifikimi dhe ndryshimi i padisë, përkatësisht përgjigja në padi

- 40.1. Nëse palët nuk janë pajtuar ndryshe gjatë procedurës së arbitrazhit, secila palë mund të ndryshojë ose plotësojë padinë e saj, duke përfshirë edhe përgjigjen ndaj ankesës, përveç kur KAS do vendos që ndryshimi apo plotësimi nuk është i përshtatshëm për shkak të zgjatjes së procedurës, ose dëmin që mund të vuajë pala e kundërt.

B.H

- 40.2. Në çdo rast, KAS nuk do të lejojë ndryshimin apo plotësimin e padisë, përkatësisht përgjigjes ndaj ankesës, për çështjet për të cilat Gjykata e Arbitrazhit Sportiv nuk është kompetent.

Neni 41 Kundërpadi

- 41.1. Pala e paditur, deri në përfundimin e seancës, mund t'i paraqesë "KAS"-it kundërpadinë ose të ngrisë një kundërshtim në formën e kundërpadisë.

Neni 42 Afatet

- 42.1. Komisioni i arbitrazhit përcakton afatet.
42.2. Gjatë përcaktimit të afateve, KAS merr parasysh natyrën e veprimeve që duhen marrë.
42.3. Afatet e përcaktuara nga KAS nuk duhet të jenë më shumë se 30 ditë.
42.4. Gjykata e Arbitrazhit Sportiv, me propozim të vet, mund të propozojë një pre palëve ose ekspertëve për të zgjatur periudhën.
42.5. Afatet e përcaktuara nga KAS do të llogariten në mënyrë që të:
b) fillon dita e parë e punës pas marrjes së vendimit nga KAS për fillimin e procedurës;
c) njoftimi, propozimi;
d) nëse ditën tjetër bie në një ditë jo-pune, vikendi, një festë zyrtare në përputhje me Ligjin për festat e Republikës së Kosovës, afati shtrihet në të parën ditë tjetër të punës.

Neni 43 Dokumentet dhe dëshmia

- 43.1. KAS do të miratojë vendimin e saj në bazë të provave me të cilat posedon;
43.2. Gjykata e Arbitrazhit Sportiv mund të kërkojë nga Këshilli i Arbitrazhit Sportiv gjatë gjithë procedurës që palët të paraqesin dokumente dhe dëshmi të tjera për përcaktimin fakteve të kontestuara apo të deklaruara në ankesë, përkatësisht përgjigje ndaj ankesës. Gjykata e Arbitrazhit Sportiv mund të autorizojë paraqitjen e provave nga njëri prej anëtarët e "GJAS";
43.3. Gjykata e Arbitrazhit Sportiv do të vlerësojë lirshëm provat dhe nuk do të jetë i ndikuar nga raporti i ekspertëve;
43.4. Të gjitha provat dhe dokumentet e paraqitura nga njëra palë në "KAS", GJAS nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm të "KAS"-it e dërgon detyrimisht tek pala e kundërt dhe përcakton afatin brenda të cilit pala kundërshtarë mund të jap dëshmi me shkrim në lidhje me dokumentet e dhëna;
43.5. Dështimi për të dhënë një përgjigje me shkrim në lidhje me dokumentet e dorëzuara nga ana e palës së kundërt, nuk nënkupton se pala pajtohet me përmbajtjen e atij dokumenti.

Neni 44 Ekspertët (të emëruar nga palët)

- 44.1. Palët janë të lira të caktojnë një ekspert i cili do të përgatitë një raport të çështjes së caktuar gjatë procedurës së arbitrazhit;
44.2. Me kërkesë të Gjykata e Arbitrazhit Sportiv ose palëve, eksperti i emëruar do të thirret për të shpjeguar gjetjet dhe mendimet e tij në një seancë dëgjimore. GJAS dhe palët janë të lira të bëjnë pyetje;

B.H

- 44.3. Gjykata e Arbitrazhit Sportiv, raportin e ekspertit, detyrohet ta dërgoj tek pala e kundërt.
44.4. Pala duhet ta dorëzojë raportin nga paragrafi 44.1 i këtij neni si një shtojcë në padi, përkatësisht përgjigje në padi;

Neni 45

Ekspertët (të emëruar nga Gjykata e Arbitrazhit Sportiv)

- 45.1. Nëse palët nuk janë pajtuar ndryshe, Gjykata e Arbitrazhit Sportiv mund të caktojë një ose më shumë ekspertë për të dëshmuar faktet, mendimet dhe çështje të tjera pranë GJAS;
45.2. Komisioni i arbitrazhit njofton palët menjëherë pas emërimit të personi i cili emërohet si ekspert;
45.3. Palët janë të obliguara, me kërkesë të ekspertit, për t'i pajisur me të gjitha dokumentet relevante përkatëse Gjykata e Arbitrazhit Sportiv, me informacione të tjera që lehtësojnë ekzaminimin e ekspertëve si dhe ofrojnë qasjen në dokumentet përkatëse;
45.4. Me marrjen e konstatimeve dhe mendimit të ekspertit, GJAS duhet t'u jep palëve afat brenda të cilit mund të deklarojnë me shkrim në lidhje me pretendimet dhe opinionet e ekspertëve;
45.5. Me kërkesën e njëres nga palët, Gjykata e Arbitrazhit Sportiv cakton një seancë dëgjimore për dëgjimin e ekspertit. Palët mund të bëjnë pyetje tek ekspertët;
45.6. Dispozitat për përjashtimin dhe moszbatimin e detyrës së një arbitri të kësaj Rregullore vlejnë edhe për ekspertin;
45.7. Kompensimi i ekspertit përcaktohet sipas rregullave të aplikueshme për kompensimin e ekspertëve në procedurën kontestimore në Republikën e Kosovës;

Neni 46

Dëshmitarët

- 46.1. Nëse palët nuk janë pajtuar ndryshe, secila palë mund të kërkojë nga Tribunali i arbitrazhit të thërrasë një apo më shumë dëshmitar dhe personi (dëshmitari) të dëgjohet në seancë dëgjimore;
46.2. Pala që dëshiron të thërrasë një dëshmitar, është i detyruar të paktën 5 ditë para ditës në seancën e dëshmitarit të jap të dhënat si emrin, adresën, gjuhën e dëshmitari, dëshmia dhe tema me shkrim tek Gjykata e Arbitrazhit Sportiv.
46.3. Gjykata e Arbitrazhit Sportiv është e detyruar të njoftojë menjëherë palën tjetër për dëshmitarin që do të merret në pyetje, si dhe për temën e dëshmisë;
46.4. Secila nga palët dhe Gjykata e Arbitrazhit Sportiv mund të bëjnë pyetje drejtuar dëshmitarit;
46.5. Dëgjimi i dëshmitarëve bëhet pa bërë betim;
46.6. Dëshmitari nuk mund të detyrohet të dënohet e as të ndëshkohet nëse refuzon të dëshmojë ose të largohet nga dëgjimi;
46.7. Dëshmitari mund të japë deklaratën e tij në një deklaratë me shkrim të nënshkruar nga vetë ai.

Neni 47

Procedura e miratuar dhe e shkruar

- 47.1. Gjykata e Arbitrazhit Sportiv do të mbajë seanca dëgjimore përveç nëse janë të pranishme palët dhe ata nuk janë pajtuar ndryshe;

B.4

- 47.2. "KAS" duhet të informojë Gjykatën e Arbitrazhit Sportiv, palët, dëshmitarët dhe ekspertët para seancës dëgjimore për ditën, orën dhe vendin e mbajtjes së seancës. Gjykata e Arbitrazhit Sportiv kur cakton një takim me gojë ose një seancë do të kujdeset që palët të kenë kohë të mjaftueshme për t'u përgaditur për një seancë dëgjimore.
- 47.3. Nëse palët nuk bien dakord ndryshe, procedura e arbitrazhit nuk është publike.
- 47.4. GJAS mund të kërkojë që dëshmitarët të jenë të pranishëm gjatë deklaratave të dëshmitarëve të tjerë.
- 47.5. Nëse palët nuk janë pajtuar ndryshe, GJAS mundet që dëgjimin e dëshmitarëve dhe ekspertëve ta bëjë përmes komunikimit me video, pra nuk kërkon praninë fizike të dëshmitarit, përkatësisht ekspertit në ambientet ku zhvillohet procedura e arbitrazhit.

Neni 48 **Procesverbalet**

- 48.1. Në seancë dëgjimore dhe seancat tjera do të mbahet procesverbali;
- 48.2. Procesverbali mbahet nga një person i autorizuar nga Sekretari i Përgjithshëm i "KAS".
- 48.3. Procesverbali nënshkruhet nga arbitrat, regjistruesi dhe palët, përfaqësuesit e tyre ose pjesëmarrësit tjerë;
- 48.4. Nëse njëra palë refuzon të nënshkruajë procesverbalin, kryetari i GJAS ose arbitri-individi e gjejnë atë në diktafon.

Neni 49 **Mbyllja e debatit**

- 49.1. Kur GJAS konsideron se lënda e kontestit është diskutuar mjaftueshëm dhe mund të marrë një vendim, do të njoftojë se dëgjimi është mbyllur.
- 49.2. Pas përfundimit të seancës, GJAS e miraton atë vendim sipas rregullave të kësaj Rregullore për marrjen e vendimit;
- 49.3. Nëse është e nevojshme të plotësohet procedura ose të qartësohet ndonjë pyetje e rëndësishme, GJAS mundet me iniciativën e vet ose më tutje me propozimin e elaboruar të njëres prej palëve, të vendos ta rihapë atë procedurë;

KAPITULLI IV – VENDIMI I ARBITRAZHIT

Neni 50 **Miratimi, forma dhe përmbajtja e vendimeve të arbitrazhit**

- 50.1. Gjykata e Arbitrazhit Sportiv do të lëshojë një vendim arbitrazhi dhe vendime të tjera me shumicë votash;
- 50.2. Dhënia e vendimit të GJAS duhet të nënshkruhet nga një arbitër ose një anëtarë të GJAS. Në procedurën e arbitrazhit me 3 arbitra nënshkrimet e shumicës së anëtarëve të këshillit të arbitrazhit janë të mjaftueshme;
- 50.3. Vendimi i arbitrazhit duhet të tregojë arsyet mbi të cilat bazohet me përjashtim të rasteve kur palët pajtohen të mos japin shpjegime;
- 50.4. Vendimet e "KAS" janë të formës së prerë në lidhje me mosmarrëveshjen e shqyrtuar;
- 50.5. Vendimet e "KAS" janë të obligueshme për të gjitha palët në kontest dhe ekzekutohen menjëherë.

- 50.6. Kundër vendimit të GJAS, mund të bëhet ankësë në CAS të Llozanës brenda 30 ditësh, pas marrjes së vendimit të KAS të KOK;
- 50.7. Aktgjykimi i GJAS duhet të përcaktojë datën dhe vendin e miratimit të tij.

Neni 51 Vendimi

- 51.1. Vendimi i GJAS është përfundimtar dhe detyron palët;
- 51.2. Palët marrin përsipër të zbatojnë aktgjykimin pa vonesë;
- 51.3. Gjykata e Arbitrazhit Sportiv është e detyruar të deklarojë aktgjykimin, përveç në rastet kur pajtohen që një shpjegim nuk është i nevojshëm;

Neni 52 Publikimet e Vendimit

- 52.1. Kur dorëzon një vendim të arbitrazhit, Kryetari i "KAS" do të i'u kërkoj palëve leje me shkrim për publikimin e vendimit të arbitrazhit në revista shkencore dhe profesionale, si dhe në faqen e internetit të KOK;
- 52.2. Nëse palët nuk pajtohen, aktgjykimi nuk publikohet;
- 52.3. Palët pavarësisht nga mosmarrëveshjet në lidhje me shpalljen e vendimit, lejojnë që vendimi të përdoret në kërkimin shkencor, por në të njëjtën kohë është e ndaluar të eksportohen të dhëna për palët dhe faktet e mosmarrëveshjes;

Neni 53 Gjykimi i pjesshëm dhe shtesë

- 53.1. Përveç gjykimit përfundimtar, Gjykata e Arbitrazhit Sportiv mund të marrë gjithashtu një vendim arbitrazhi, nëse një pjesë e kërkesës është shqyrtuar;
- 53.2. Për kërkesat që Komisioni i Arbitrazhit nuk ka vendosur, secila palë mund të kërkojë që brenda 30 ditëve nga data e marrjes së aktgjykimit nga Gjykata e Arbitrazhit Sportiv për të dhënë një gjykim shtesë;
- 53.3. Nëse Gjykata e Arbitrazhit Sportiv vendos që duhet të sjellë një shtesë në aktgjykim, do ta miratojë atë brenda 30 ditëve nga dita e pranimit të kërkesës për miratimin e saj;

Neni 54 Interpretimi dhe korrigjimi i aktgjykimit

- 54.1. Brenda 30 ditëve nga data e pranimit të aktgjykimit, secila palë, duke informuar palën kundërshtare për këtë, mund të kërkojnë interpretimin e "KAS"-it për një vendim të arbitrazhit apo pjesë të vendimit të caktuar;
- 54.2. Nëse KAS konsideron se kërkesa është e justifikuar, ajo duhet të jap interpretimin me shkrim brenda 30 ditëve nga data e depozitimit të kërkesës për interpretimin e aktgjykimit;
- 54.3. Brenda 30 ditëve nga data e pranimit të aktgjykimit, secila palë, duke informuar palën tjetër, mund të kërkojnë nga Gjykata e Arbitrazhit Sportiv që të korigjohet një pjesë e vendimit, qoftë për korrigjimin e kontabilitetit, gabim teknik ose shtypës ose ndonjë gabim i një natyre të ngjashme;
- 54.4. Gjykata e Arbitrazhit Sportiv, me nismën e vet, mund ta korrigjojë atë gabim brenda 30 ditëve nga data e aktgjykimit;

B.H

- 54.5 Nëse Gjykata e Arbitrazhit Sportiv konsideron se kërkesa është e justifikuar, korrigjimi i aktgjykimit do të përgatitet me shkrim, brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës për korrigjimin e aktgjykimit;
- 54.6 Gjykata e Arbitrazhit Sportiv nuk duhet të llogarisë shpenzimet për korrigjimin e aktgjykimit;
- 54.7 Dispozitat e këtij neni i referohen aktgjykimit, aktgjykimit të pjesshëm dhe gjykimit shtesë;

Neni 54

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

- 55.1. Gjatë procedurës së arbitrazhit, palët mund të zgjidhin mosmarrëveshjen me bisedime dhe mirëkuptim;
- 55.2. Nëse marrëveshja arrihet gjatë procedurës ose nëse të dyja palët e kërkojnë atë, Gjykata e Arbitrazhit Sportiv do të japë një vendim arbitrimi në bazë të marrëveshjes;
- 55.3. Gjykata e Arbitrazhit Sportiv nuk është i detyruar të shpjegojë dhënien e arbitrazhit të miratuar në bazë të një marrëveshjeje nga palët;

Neni 56

Përfundimi i procedurës së arbitrazhit

- 56.1. Procedura e arbitrazhit përfundon me miratimin e një vendimi të arbitrazhit;
- 56.2. Procedura e arbitrazhit mund të përfundojë nëse:
- a) Pala paditëse e tërheq ankesën, përveç nëse pala e paditur e kundërshton atë, apo GJAS e konsideron se pala e paditur ka një interes të ligjshëm për të marrë një vendim përfundimtarë mbi mosmarrëveshjen;
 - b) nëse palët janë pajtuar të përfundojnë procedurën;
 - c) nëse Gjykata e Arbitrazhit Sportiv konstaton se vazhdimi i procedurës, nga çdo arsye u bë e panevojshme ose e pamundur;

Neni 57

Ankesa kundër vendimeve të "KAS"

- 57.1. Kundër vendimit të arbitrazhit nuk lejohet një mjet juridik në një gjykatë më të lartë në Kosovë;
- 57.2. Vendimet e "KAS" janë të formës së prerë dhe janë përgjithësisht të paankimueshme, duke përjashtuar këtu vetëm rastet si në vijim:
- a) Gjykata e Arbitrazhit Sportiv është formuar në mënyrë të parregullt;
 - b) "KAS" pa të drejtë ka deklaruar kompetencen e tij për gjykimin e mosmarrëveshjes;
 - c) "KAS" në vendimin e saj tejkalon kërkesat për të cilat është investuar, ose nuk është shprehur mbi një nga kërkesat kryesore të padisë;
 - d) Nuk është respektuar barazia e palëve dhe e drejta e tyre për t'u dëgjuar në një procedurë të mbështetur në parimin e kontradiktoritetit;
 - e) Vendimet e "KAS" bien në kundërshtim me rendin publik në Republikën e Kosovës.
- 57.3. Vendimet në rastet e lartëpërmendura lejohet ankimi në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, brenda 30 ditëve nga dita e shpalljes së vendimit;

B.H

KAPITULLI V – KOSTOT PËR HAPJEN E PROCEDURAVE NË KAS

Neni 58

Shpenzimet për hapjen procedurës

- 58.1. Palët që marrin pjesë në procedurën para vetë “KAS” i mbulojnë vetë shpenzimet e procedurës, e që përbëhen nga:
- a) shpenzimet administrative të “KAS” dhe
 - b) shpenzimet materiale të procedurës (shpenzimet për përkthime dhe shpenzime të tjera).
- 58.2. Pala që fillon procedurën duhet të bëjë pagesën e nevojshme për fillimin e procedurës në xhirollogarinë e KOK;
- 58.3. Palët i paguajnë shpenzimet e procedurës së arbitrazhit sipas vendimit të nxjerrë nga KOK;

Neni 59

Vendimi përfundimtar për shpenzimet e procedurës

- 59.1. Në vendimin përfundimtar të marrë në procedurën e arbitrazhit, Gjykata e Arbitrazhit Sportiv do të marrë vendim për rimbursimin e shpenzimeve;
- 59.2. Gjykata e Arbitrazhit Sportiv do të vendosë në vendimin për kompensimin e shpenzimeve cila palë është e detyruar ta kompensojë palën tjetër si dhe për shpenzimet e procedurës dhe shpenzimet e veta, duke e marrë parasysh suksesin e procedurës;
- 59.3. Nëse palët nuk janë pajtuar ndryshe, shpenzimet e procedurës do të duhet të kompensohen nga pala që ka humbur në procedurë, përkatësisht në rast se kërkesa është miratuar pjesërisht, shpenzimet paguhet nga të dyja palët, në proporcion me pjesën e miratuar ose të refuzuar të padisë.

Neni 60

Obligimet Financiare

- 60.1. Gjatë paraqitjes së ankesës, paditësi është i detyruar të paguajë një tarifë hyrjeje në shumën e përcaktuar me vendim të BE të KOK si dhe vërtetimin e pagesës së paguar ta dorëzojë së bashku me ankesë/padi tek Sekretari i Përgjithshëm i “KAS”.
- 60.2. Sekretari i Përgjithshëm i “KAS” do të dorëzojë ankesën së bashku me provën e pagesës se detyrimet janë plotësuar.
- 60.3. Tarifa e regjistrimit të paguar nuk është e rimbursueshme.

Neni 61

Kostoja paraprake e procedurës

- 60.1. Shpenzimet e procedurës nga neni 58 paguhet nga paditësi paraprakishtë.
- 60.2. Shuma e parapagimit nga paragrafi 1 i këtij neni përcaktohet nga BE e KOK me vendim paraprak.

Neni 62

Kostoja paraprake e pagesës së procedurës

- 62.1. Sekretari i Përgjithshëm i “KAS” do ta thërrasë paditësin me një thirrje me shkrim për të paguar parapagimin, në afat prej 5 ditëve nga data e dorëzimit të padisë.

- 62.2. Nëse paditësi nuk paguan parapagimin në periudhën e parashikuar, Kryetari i “KAS” do të vendosë për mos shqyrtim të padisë.
- 62.3. Ankesa e fshirë mund të paraqitet përsëri, me pagesë të përfunduar.

Neni 63

Shpenzimet e tjera

- 62.1. Shpenzimet që lidhen me kryerjen e proceseve individuale (kostot e ekspertizës, paraqitja e provave, etj.) janë në vazhdim barra e palës që propozon marrjen e tyre, e cila duhet të depozitohet shumën e duhur paraprakisht;
- 62.2. Vendim për pagesën e parapagimit për shpenzimet nga paragrafi 62.1 i këtij neni , e jep arbitri - një individ apo kryetari i GJAS.
- 62.3. Nëse parapagimi i shpenzimeve nga paragrafi 62.1 i këtij neni nuk është paguar, nuk do të ndërmerren veprimet e procesit;
- 62.4. Nëse shpenzimet e procedurës së arbitrazhit nga paragrafi 62.1 i këtij neni janë sipas kërkesës ose me pëlqimin e të dy palëve, secila nga palët paguajnë gjysmën e paradhënies;
- 62.5. Të gjitha llojet e shpenzimeve të procedurës së arbitrazhit do të përcaktohen me një vendim të veçantë të BE të KOK;
- 62.6. Anëtarët e KAS paguhen për punën e tyre, mënyra e pagesës do të rregullohet me një akt të veçantë nënligjor të miratuar nga BE i KOK;

KAPITULLI VI – DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE DHE KALIMTARE


Neni 64

- 64.1. Dispozitat e kësaj rregullore zbatohen për procedurat e arbitrazhit të cilat janë iniciuar pas hyrjes së saj në fuqi.

Neni 65

- 65.1. Kjo Rregullore publikohet në web faqen e KOK brenda 3 ditëve nga data e miratimit të saj dhe do të hyjë në fuqi pas miratimit nga Asambleja e Përgjithshme e KOK.

Besim Hasani,



President i Komitetit Olimpik të Kosovës

